

VENDIM
Nr. 560, datë 29.7.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA KAVAJË, TË PRONËS NR. 365, ME EMËRTIM “ISH-BATERIA ABD”, ME VENDNDODHJE NË KALANË E TURRËS, SYNEJ, KAVAJË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Kavajë, të pronës nr. 365, me emërtim “Ish-bateria ABD”, me vendndodhje në Kalanë e Turrës, Synej, Kavajë, sipas formularit standard të inventarizimit dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për ta përdorur për realizimin e projektit për ndërtimin e portit turistik të jahteve, në Kalanë e Turrës, Synej, Kavajë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 365, me emërtim “Ish-bateria ABD”, me vendndodhje në Kalanë e Turrës, Synej, Kavajë, e cila i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i janë transferuar në pronësi apo në përdorim Bashkisë Kavajë.

3. Bashkisë Kavajë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, objekteve dhe të truallit funksional, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Kavajë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE (Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)


MINISTRIA E MBROJTJES			Identifikoi : Roland Llazari <i>[Signature]</i> SHKËNËZITPP; ARBEN SULO Drejtori i DMPM. <i>[Signature]</i>		
Komuna Synej, Kavajë			Supervizoi : N/Kol. Vasil Lelaj , Shëf Sektorit J3/7; N/Kol. Jetmir Balla , OF/Shtabi J3/7; <i>[Signature]</i>		
Fusha e përdorimit të pronës :			N/Kol. Aurora Matoshi , Specialiste J-4, Major Petrit Sade Specialist J-6. <i>[Signature]</i>		
Për Mbrojtjen Kombëtare			Aprovoi : Kolonel VLADIMIR AVDIAJ , Drejtor i Drejtorisë Operacionale dhe Stërvitjes. <i>[Signature]</i>		

A			B			C				
Nr	Zona Kadast Indeksi i hartës	Numëri pasurisë	Emërtesa e pronës Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e Pronës në M2 ose MI	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me Përgjegjësi Administrative	Enti Përdorues Statusi Juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
365	ZK Nr.2909 Çert Datë 01.12.04	Nr. 219/1 Pas	Ish Bateria ABD		Kala e Turrës, Synëj, Kavajë	600139.54 M2	Për Mbrojtjen	Ministria Mbrojtjes Rep. Usht. Nr.2001(KFD) Durrës	Reparti Usharak Nr.2230 Durrës	- Identifikuar me të dhënat e formularit standard dhe të planvendosjes, të dërguar nga KFD, me Nr.2708/8, dat 03.12.2010
				Mencë Kuzhinë		60.5				
				Kabinë elektrike		12.2				
				Depo		176.3				
				Depo		46.5				
				WC		(4)				
				Park depo		388.6				Rënuar
				Dushë WC		29.6				
				Depo furrë buke		75.5				
				Depo armatimi		70.2				

[illegible]

PLAN-VENDOSJA E PRONS Nr. 365 "BATERIA ABD" KALAJA E TURRËS KAVAJË

SISTEMI I KORDINATAVE SHETERORE



SHPIEGUESE:

